

Plani Strategjik Bashkia Burrel 2004 - 2008



Janar – Qershor 2004

1. Hyrje

Plani Strategjik eshte nje dokument qe permban pershkrimin e rruges se zhvillimit te qytetit te Burrelit dhe u jep pergjigje pyetjeve, ku jemi, çfare duhet te bejme, pse duhet ta bejme dhe si duhet bere. Keto jane 4 pyetje qe administrata e Bashkise Burrel ne bashkpunim me partneret e saj eshte perpjekur t'ju jape pergjigje.

Plani Strategjik qe ju paraqitet eshte nje ndermarrje e Bashkise Burrel ne bashkpunim me Organizaten Hollandeze per Zhvillim SNV. Nisur nga fakti qe hartimi i planit strategjik eshte i domosdoshem, stafi i bashkise dhe strukturat jo te vartesis nisen punen per grumbullimin e te dhenave dhe perpunimin e tyre qe ne muajin Dhjetor 2003. Procedura dhe aktivitetet u percaktuan ne baze te nje kalendari te miratuar nga grupi kordinues dhe keshilltaret e SNV.

Kontributi i komunitetit ishte me i madhi, me idete dhe me sugjerimet e dhena nga qytetaret qe u mblodhen nepermjet pyetesorit dhe takimeve te drejtperdrejta.

Zhvillimi i planit strategjik eshte konceptuar ne nje ambient qe ndryshon ne menyre te vazhdueshme nga kerkesat e qytetareve, nga rregullat dhe politikat e Qeverise si dhe nga tendencat e zhvillimit. Plani Strategjik eshte nje proces i cili ka qellimet dhe objektivat te percaktuara qarte, qellime dhe objektiva qe synojne arritjen e vizionit "Ta bejme Burrelin qytet ku me pelqen te jetoj".

Ne modulim e planit strategjik paraqiten nje grup qellimesh dhe objektivash dhe per realizimin e tyre kerkohet nje buxhet I madh. Por ka nje te vertete te madhe se ne kushtet qe gjendet sot qyteti I Burrelit, ku ka nje infrastrukture qe eshte e pershtateshme per nje numer popullsie 7500 banore dhe qe sot Burreli ka nje numer banoresh qe afrohet 20000 dhe ka po te njejten infrastrukture te njetat ambiente shkollore, kulturore, te njejten infrastrukture shendetesore, te njejten infrastrukture biznesi, ku nuk funksionojne te gjitha ndermarrjet qe kane qene ne Burrel dhe qe ka nje papunesi te larte dhe nje nivel pasigurie te larte. Ne qytetin e Burrelit vazhdon te kete nje rritje te lehte te popullsisë ne tre vitet e fundit. Perballe kesaje rritje te popullsisë shtrohet si detyre qe administrata te hartoj politika te tilla zhvillimi qe te parashikojne permirsime dhe shtim te infrastruktures ne perputhje me kete rritje. Une mendoj se administrata e Bashkise ka vendosur objektiva ambicioze dhe realizimi I tyre varet shume nga bashkpunimi me institucione e tjera jo te vartesis, realizimi I objektivave varet nga hapat qe do te beje qeveria ne drejtim te decentralizimit ne drejtim te ligjit te pronave te paluajteshme qe kalojne ne vartesi te Bashkise, ne miratimin e ligjit te kredive dhe ligjeve te tjera qe jane te domosdoshme per mbarevajtjen e punes se njesive te qeverisjes vendore. Proceset integruese europiane kerkojne ngritjen e nje rrjeti administratorësh lokal te afte qe te bejne sfide ketij integrimi. Puna dhe menaxhimi I resurseve dhe I vlerave me te mira te qytetareve te qytetit te Burrelit do te jete sfida me te cilen ne do te perballemi me sukses, kjo perballje kerkon bashkpunimin dhe predispozicionin e te gjithë qytetareve, intelektualeve, punonjeseve te administrates civile. I vetem nuk mund te behet asgje, sebashku bejme gjithçka. Nepermjet ketij manuali une kerkoj bashkpunimin e te gjithë qytetareve, qeverise, donatoreve dhe OJF qe jane te pranishem ne Burrel.

SKENDER LLESHI.

KRYETAR I BASHKISE BURREL

2. Permbajtja

1. Hyrje	2
2. Permbajtja	3
3. Permbledhja	4
4. Parathenie	5
5. Metoda e ndjekur	5
6. Profili i bashkise	6
▪ Gjeografia	6
▪ Historia	7
▪ Popullsia	7
▪ Punesimi dhe ekonomia lokale	7
▪ Organizimi i pushtetit vendor	8
▪ Arsimi, shendetesia, kultura dhe sporti	8
7. Analiza e gjendjes	9
▪ Analiza e bashkise	9
▪ Lista e problemeve	10
8. Orientimet strategjike	11
▪ Vizioni	11
▪ Fushat prioritare	11
- Zhvillimi ekonomik	11
- Rendi dhe qetesia	12
- Infrastruktura	13
- Arsim & Kulture	18
- Shendetesi	20
9. Anekset	21
- Rezultatet e pyetesorit	
- Lista e aktoreve ; lista e pjesemarresve	

3. Permbledhje

Dokumenti i Planit Strategjik te Bashkise se Burrelit eshte rezultat i nje pune te bere nga te gjithë aktoret lokale. Orientimet strategjike te paraqitura ne kete dokument, jane nje orientim per administraten dhe keshillin bashkiak ne aktivitetin e tyre te perditshem. Eshte dashur nje kohe prej 7 muajsh per te formuluar dhe hartuar kete dokument. I gjithë informacioni i mbledhur dhe i perpunuar gjate kesaj kohe ka sherbyer si baze per te hartuar kete dokument. Kjo gje vlen sidomos per profilin e qytetit. Nje material i plote dhe i detajuar gjendet ne zyrat e bashkise vetem mbi profilin e qytetit te Burrelit.

Ne fillim te dokumentit te planit strategjik eshte paraqitur nje permbledhje e profilit te bashkise duke permendur shkurtimisht disa nga treguesit me domethenes mbi popullsine, punesimin, aktivitetin ekonomik, organizimin & e pushtetit vendor, sherbimet qe ofrohen nga bashkia, pasi nje tablo te plote mbi bashkine e Burrelit mund ta gjejme duke shfletuar dokumentin e profilit.

Pjese e rendesishme e planit strategjik eshte edhe analiza e gjendjes aktuale dhe lista e problemeve te cilet jane renditur sipas prioriteve. Kjo renditje eshte bazuar ne rezultatet e pyetesorit te plotesuar nga qytetaret. Pikerisht bazuar ne keto probleme dhe ne fushat ku ato bejne pjese, jane paraqitur edhe orientimet strategjike te zhvillimit.

Zhvillimi ekonomik eshte trajtuar me perpara nga te gjithë fushat e tjera per faktin e thjeshte qe poblemet me prioritare qe kerkojne zgjidhje jane te lidhura me kete fushe.

Me pas paraqiten disa nga qellimet dhe objektivat strategjike qe kane te bejne me rendin dhe qetesine pasi per qytetin e Burrelit problemet e lidhura me rendin dhe sigurine publike vazhdojne te mbeten shume te ndjeshme.

Nje vend te konsiderueshem zene edhe problemet e infrastructures dhe disa nga mundesite per zgjidhjene tyre.

Arsimi dhe shendetesia jane dy fushat e fundit te trajtuara ne kete document.

Per te gjitha qellimet strategjike jane paraqitur aktoret pergjegjues per realizimin e tyre dhe ne te njejten kohe edhe nje buxhet i peraferte qe nevojitet dhe ne disa raste edhe informacioni nese ka project te gatshem apo projekti eshte duke u pergatitur.

Duhet theksuar qe ky document eshte i pari i ketij lloji i pergatitur nga bashkia e Burrelit, prandaj rishikimi dhe permiresimi i tij do te vazhdoje te jete nje angazhim i grupit te punes dhe keshillit bashkiak.

4. Parathenie

Bashkia e Burrelit eshte nje nga 4 bashkite e qarkut te Dibres, i cili eshte nje nga qarqet me te varfra te Shqiperise qe shtrihet ne zonen verilindore. Problemet dhe sfidat me te cilat kjo bashki ndeshet jane pjese e nje realiteti tashme te njohur, sidomos per ata qe jane pjese e administrates publike. Nje nga problemet me te mprehta ka qene rendi dhe qetesia e lidhur kjo edhe me numrin e madh te te papuneve. Megjithatë permiresimet e vazhdueshme qe nga viti '97 e ne vazhdim perseri qytetaret e Burrelit ndihen jo shume te sigurte ne qytetin e tyre.

Per te perballuar me sukses keto sfida te kohes, pare kjo edhe ne kontekstin e krijimit te nje qeverisje sa me pjesemarrrese dhe demokratike, bashkia e Burrelit nen drejtimin e kryetarit te saj e konsideroi si nje prioritet kryesor hartimin e nje plani strategjik mbi zhvillimin e bashkise se Burrelit deri ne vitin 2008. Planit Strategjik ndihmoi bashkine dhe te gjithat aktoret e Burrelit te analizonin problemet si dhe te vendosin disa orientime strategjike ne lidhje me zhvillimet e bashkise per nje periudhe kohore 4-vjeçare. Bazuar ne nje dokument te tille, te gjitha perpjekjet nga ana e bashkise, dhe e te gjithat aktoreve te tjere per te realizuar qellimet dhe objektivat strategjike te percaktuara ne plan do te jene te koordinuara dhe jo spontane. Vete qytetaret e dine se ku presin ta shohin qytetin e tyre ne 2008 dhe se çfare duhet bere per te arritur atje.

Pjese e punes per hartimin e planit strategjik ka qene edhe njohja dhe pershtatja e Objektiveve te Zhvillimit te Mijevjeçarit si dhe e strategjive kombetare te zhvillimit ne nivel lokal.

5. Metoda e ndjekur

Procesi i hartimit te Planit Strategjik u drejtua nga nje grup pune i perbere nga perfaqesues te administrates, keshillit bashkiak, perfaqesues te institucioneve dhe qytetare te ndryshem. Synimi kryesor i bashkise dhe i kryetarit te saj ishte realizimi i nje procesi sa me pjesemarrres dhe produkti i ketij procesi te ishte frut i punes te te gjithat aktoreve. Fillimisht u hartua nje plan pune ne te cilin u planifikuan te gjithat hapat qe do te ndiqeshin. Nje nder hapat e para ishte identifikimi i aktoreve qe do te perfshiheshin ne procesin e planifikimit strategjik. Aktoret e identifikuar, te grupuar sipas problematikes dhe fushave perkatese, u perfshine drejtperdrejt ne mbledhjen e te dhenave, ne analizimin e problemeve dhe ne percaktimin e orientimeve strategjike.

Gjate gjithat procesit te planifikimit strategjik nga grupet e punes jane patur parasysh disa orientime dhe strategji kombetare me qellim qe plani i zhvillimit te Burrelit te jete ne te njejten linje me keto dokumenta, si Shqiperia dhe Objektivat e Mileniumit, Strategjia Kombetare per Zhvillimin Social Ekonomik si dhe Strategjite Sektoriale te miratuara nga Keshilli i Ministrave.

Kujdes i veçante iu tregua perfshirjes se qytetareve ne process. Per kete arsye u pergatiten dhe u shperndane dy pyetesore perkatesisht per qytetaret dhe per biznesmentet. Nga perpunimi i ketyre pyetesoreve u nxorren edhe

prioritetet e bashkise se Burrelit. Bazuar ne te dhenat e grumbulluara u organizuan edhe disa takime dhe diskutime me grupe te ndryshme qytetaresh per te siguruar nje opinion sa me te gjere ne lidhje me planin e zhvillimit.

I gjithe procesi u percoll tek qytetaret nga televizioni local, i cili pasqyroj takimet e ndryshme si dhe hapat konkrete te ndermarra nga bashkia per te realizuar hartimin e planit strategjik per qytetin e burrelit.


I gjithe procesi i hartimit te planit strategjik u mbeshtet nga SNV (Organizata Hollandeze per Zhvillim). Mbeshtetja e dhene konsiston ne keshillim per grupet e punes, trainim per personat e perfshire, lehtesim te procesit te perfshirjes se aktoreve te ndryshem si dhe mbeshtetje ne realizimin e perfshirjes se qytetareve.

Procesi i Planifikimit Strategjik ka filluar ne dhjetor te vitit 2003 me diskutimet mbi domosdoshmerine e hartimit te nje plani strategjik dhe rendesine qe ka per autoritetet lokale pasja e nje dokumenti te tille. Pergatitja dhe botimi i planit strategjik ne korrik 2004 mund te kosiderohet si nje nga hapat e fundit te ketij procesi, per te vazhduar me perpjektjet e panderprera qe duhet te beje bashkia dhe te gjithe aktoret e tjere per te zbatuar planin e pergatitur.

6. Profili i shkurter i bashkise se Burrelit

a. Gjeografia

Qyteti i Burrelit, i cili shtrihet ne verilindje te Shqiperise dhe ndodhet 86 km larg Tiranes, eshte ngritur mbi fshatin me te njejtin emer dhe shtrihet ne nje tarace lumore qe ka pamjen e nje pllaje. Distancat e qytetit te Burrelit prej disa nga qendrat me kryesore te vendit jane paraqitur ne skemen e meposhtme



Lartesia mbi nivelin e detit varion nga 250 – 350 m. Klima eshte kontinentale mesatare me vere te nxehte dhe te thate dhe me dimer te ftohte e te laget. Temperaturat variojne nga -15 grade celcius deri ne +38 grade ne vere.

- Historia

Burreli është i banuar qysh në shek. XII para krishtit dhe deri në vitin 1922 ka qenë fshat, pa ndonjë rëndësi administrative. Në vitin 1922 qendra administrative që ndodhej në Kombsi (7 km larg), u shpërngul dhe u vendos në Burrel. Pas këtij viti qyteti gradualisht mori formën e një qendre të rëndësishme urbane. Në vitin 1955 Burreli mori statusin e qytetit dhe kështu vazhdon edhe sot. Burreli vazhdon të mbetet qendra dhe qyteti kryesor i krahinës së Matit.

- Popullsia

Nga pikepamja e përzierjes së popullsisë 99.85 % në rrethin e Matit janë shqiptarë dhe vetëm 0.15 % kombësi të tjera. Nga pikepamja e besimit fetar 80 % e popullsisë së Burrelit janë të fesë myslimane.

do të shtohet Harta e Qytetit

Popullsia e këtij qyteti ka ardhur duke u rritur gjatë dekadës së fundit për shkak të migrimit të njëzë nga fshatrat përreth. Gjithashtu vëhet re edhe një tendencë tjetër që kanë banorët e Burrelit për t'u larguar në zonat urbane me të mëdha si Tirana, Durrësi etj.

Viti	1990	1995	2000	2004	
Popullsia	10 500	16 818	17 908	17 928	
Gjinia				8999 F	8929 M
Largimet	171	250	833	1023	
Ardhjet	1730	314	631	349	

- Punesimi dhe ekonomia lokale

Shumica e banorëve të Burrelit bëjnë një jetë të vështirë, për shkak të gjendjes ekonomike të varfër. Niveli i punësimit është relativisht i ulët kjo vjen si pasojë e paralizimit të aktivitetit prodhues. Aktiviteti kryesor i tyre është punësi në aktivitete të ndryshme private, me menaxhimin e një dyqani të vogël për tregëti ose për të ofruar shërbime të ndryshme, si dhe tregëti në rrugë. Një pjesë e vogël njëzësh janë të punësuar në administratën publike dhe në institucionet e tjera shtetërore. Numri i të papunëve është relativisht i lartë.

Viti	Te punësuar	Te papunë		
	Gjithsej	Femra	Meshkuj	Gjithsej
2002	3824	1206	2458	3664
2003	3568	1163	2489	3552

Bazuar në të dhënat e marra nga dega e tatimit të shtesë në lidhje me numrin e subjekteve që kanë aktivitet privat në bashkinë e Burrelit është paraqitur tabela e mëposhtme.

Viti	2000	2001	2002	2003
Numri i subjekteve të biznesit të vogël	311	316	313	314
Numri total i subjekteve	388	378	376	392

- Organizimi i Pushtetit Vendor

Bashkia e Burrelit ka nje administrate me 35 punonjese dhe keshill bashkiak me 17 keshilltare.

	Administrata		Keshilli Bashkiak	
Numri	35 punonjes		17 keshilltare	
Perkatesia gjinore	48 % femra	52 % meshkuj	12% femra	88% meshkuj
Arsimimi	82 % arsim i larte	18 % arsim i mesem	88% arsim i larte	12 % arsim i mesem

Bashkia ofron sherbime publike per qytetaret e saj drejteperdrejt si dhe me sipermarrje private. Nje pasqyre e sherbimeve kryesore paraqitet si me poshte:

Nr	Lloji i sherbimit	Menyra e realizimit
1.	Pastrimi (grumbullim; transport)	Me sipermarrje private
2.	Mirembajtja e ruge - kanalizimeve	Nga ndermarrja sherbime bashkiake ne varesi te bashkise.
3.	Gjelberimi	Me sipermarrje private
4.	Furnizimi me energji elektrike	Filiali elektrik
5.	Sherbimi telefonik	Shoqeri anonime
6.	Furnizimi me uje te pijshem	Bashkia – Sh A
7.	Ndricimi rrugor	Bashkia
8.	Sherbimi funeral	Me sipermarrje
9.	Sherbimi i dekorit publik	Me sipermarrje

Vitet	Buxheti Qeveria Qendrore	Te ardhurat e veta te Bashkise	Totali
2000	160 850	6 239	167 089
2001	173 606	8 633	182 239
2002	197 811	12 154	209 965
2003	162 213	15 501	177 714

- Arsimi, shendetesia, kultura dhe sporti

Ne bashkine e Burrelit aktualisht jane 5 shkolla, nga keto 3 jane shkolla tetevjeçare dhe 2 te mesme. Numri i nxenesve qe mesojne ne 5 shkollat e qytetit eshte 3649 nga keto numrin me te madh e perbejne nxenesit e shkollave tetevjeçare perkatesisht 2677. Numri i mesuesve eshte 172.

Ne bashkine e Burrelit funksionojne edhe 3 kopshte femijesh me nje kapacitet 510 femije. Numri i edukatoreve te kopshteve eshte 29.

Sherbimi shendetesor eshte i organizuar nepermjet sherbimit shendetesor paresor dhe ate spitalor. Spitali i qytetit me nje kapacitet 165 shtrere te ndare sipas reparteve perkatese ne pergjithesi eshte ne gjendje te mire fizike. Persa i perket aparaturave dhe pajisjeve te spitalit pjesa me e madhe e tyre

eshte e vjeteruar dhe e amortizuar. Problemi kryesor eshte i lidhur pikerisht me nderrimin e aparaturave dhe krijimin i nje reparti te terapise intensive.

Ne territorin e bashkise funksionojne 3 ambulanca lagjesh me 9 mjeke te pergjithshem dhe te familjes nga te cilet 3 kryejne vizita per femijet dhe 6 per te rritur. Gjendja fizike e qendrave ambulatorie neper lagje nuk eshte e mire, mesatarisht jane 6000 banore per nje qender shendetesore dhe 1 mjek per 1700 banore.

Pallati i kultures eshte nje nga institucionet social – kulturore me te rendesishme. Eshte ndertuar ne vitin 1970, me nje kapacitet 450 vende. U shkaterua ne vitin 1997 dhe u rikonstruktua ne vitin 2001. Sot funksionon si qender edukimi dhe komunikimi per te rinjte dhe te gjithe grupet e te interesuarve.

Muzeu historik eshte ngritur qe ne vitin 1967. Godina e re mbaroi se ndertuari ne vitin 1986 e cila u demtua gjate trazirave te vitit 1997. Aktualisht funksionon vetem kati i pare i godines.

Kinemaja e qytetit e ndertuar ne vitin 1957 nuk funksionon. Ka nevoje per rikonstruksion te plote.

Teatri i kukullave perfundoi se ndertuari ne vitin 1993. Salla e shfaqeve ka nje kapacitet prej 100 vendesh. Funksionon rregullisht duhen me shume pajisje. Biblioteka e qytetit u shkaterrua gjate trazirave te vitit 1997. Rikonstuksioni i godines eshte bere ne vitin 1998.

Bashkia e Burrelit ka nje stadium te ndertuar ne vitin 1986 , me nje kapacitet 12 000 spektatore. Gjithashtu gjendet edhe godina e Pallatit te Sportit.

7. Analiza e gjendjes

- Analiza e Bashkise Burrel

Nje aktivitet i rendesishem ne kuadrin e procesit te planifikimit strategjik i realizuar qe ne hapat e para ishte edhe analizimi i gjendjes reale te bashkise se Burrelit. Per te krijuar nje tablo me te qarte se ku ndodhej bashkia, nga grupi i punes, i drejtuar nga kryetari i bashkise u realizua nje analize SWOT.

Pikat e forta te bashkise	Dobesite
<ul style="list-style-type: none">➤ Bashkepunimi i mire i administrates me keshillin bashkiak.➤ Burime njerezore te kualifikuara dhe me	<ul style="list-style-type: none">➤ Nevoja e trainime per personelin➤ Burokracia ul eficensen e administrates.➤ Mungese informacioni ne lidhje me zhvillimin urban.

<p>eksperience.</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Komunikimi ne rritje me komunitetin. ➤ Funksionimi i drejte dhe eficient i strukturave dhe institucioneve lokale. ➤ Ekzistenca e vlerave historike dhe kulturore te qytetit. ➤ Rregjistrimi i pronave publike 	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Policia ndertimore nuk funksionon. ➤ Koha e shkurter e drejtimimit te strukturave te zgjedhura. ➤ Mungesa e strukturave projektuese te organizuara.
<p>Mundesite</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Hapesirat e krijuara nga decentralizimi ➤ Rritja e te ardhura lokale ➤ Krijimi i policise bashkiake ➤ Afersia gjeografike me Tiranen (ministrite dhe institucionet qendrore) ➤ Ekzistenca e organizatave lokale dhe te huaja qe ofrojne asistence per rritje kapaciteti dhe financime. 	<p>Kercenimet</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Te ardhura te pakta nga buxheti qendror ➤ Vonesa ne mbledhjen e te ardhurave te biznesit te vogel. ➤ Motivimi i pakte i njereseve qe punojne ne administraten publike.

Nga kjo analize u be e mundur te nxirren edhe disa nga problemet kryesore qe qyteti i Burrelit ka aktualisht. Pasi u analizuan problemet dhe u paraqiten ato tek qytetaret dhe grupet e ndryshme u be nje renditje e tille si me poshte.

▪ **Lista e problemeve sipas prioriteteve**

1. Papunesia
2. Forcimi i rendit dhe i qetesise
3. Rikonstruksioni i rrugëve
4. Strehimi
5. Prishja e ndertimeve te paligjshme
6. Rikonstruksioni i ujesjellesit
7. Kanalizimet e ujrave te perdorura
8. Rikonstruksioni i rrjetit elektrik
9. Gjelberimi
10. Nxitja e biznesit
11. Rikonstruksioni i kendit te lojrave
12. Menaxhimi i mbetjeve urbane
13. Sistemimi i tregut
14. Ndertimi i nje fushe per mbetjet urbane
15. Ndertimi i nje shkolle te re
16. Ngritja e bibliotekave neper shkolla
17. Rikonstruksioni i kopshteve dhe çerdheve
18. Fasadat e pallateve
19. Pajisja e laboratorit te spitalit
20. Ngritja e parkingjeve.

8. Orientimet strategjike

➤ Vizioni

Deri ne 2008 Burreli do te jete nje qytet i gjelberuar, ku njerezve u pelqen te jetojne dhe te punojne, qytetaret jane te mireushqyer, te shendetshem dhe te arsimuar. Ata kane akses te barabarte ndaj gjithë sherbimeve qe ofron Bashkia e tyre.

➤ Fushat prioritare dhe objektivat strategjike

a. Zhvillimi ekonomik

Zhvillimi ekonomik i qytetit te Burrelit konsiderohet si nje nga prioritetet kryesore qe do te sjelle zgjidhjen e problemeve me te medha qe ka qyteti. Sipas analizes se bere problemi me kryesor eshte papunesia e larte ne kete bashki qe ka ardhur edhe si pasoje e paralizimit te aktivitetit prodhues dhe e mbylljes se shume fabrikave dhe ndermarrjeve.

Problemi1: Papunesia

Qellimi strategjik 1. Ulja me 5% e numrit te papuneve ne bashkine e Burrelit per çdo vit deri ne 2008. (Bazuar ne Synimin 1 te MDG mbi pergjysmimin e numrit te njeresve qe jetojne ne varferi ekstreme nga 2002 - 2015)

Objektivi 1.1

Krijimi i mundesive per punesim nepermjet hapjes se vendeve te reja te Punes nga:

- Hapja e punishteve artizanale e perpunim drurit (shelgjeve).
- Rihapja e aktiviteve bazuar ne traditen e meparshme.
- Zgjidhja perfundimtare e problemit te pronave.

Objektivi 1.2

Krijimi i partneriteteve midis Pushtetit lokal dhe i biznesit nepermjet

- Riorganizimit dhe mbeshtetjes se dhomes se tregetise. Krijimi i lehtesirave per kete strukture nga ana e bashkise.
- Stimulimi i biznesit ekzistues nepermjet hartimit te nje sistemi taksash favorizues per biznesin.
- Nxitja e institucioneve dhe organizatave te ndryshme per te dhene kredi per sektorin e biznesit.
- Krijimi i lehtesirave proceduriale per zgjerimin e aktivitetit te biznesit ekistues.

Aktoret pergjegjes

Bashkia Burrel

Zyra e taksave

Zyra e punes dhe e çeshtjeve sociale

Komuniteti i biznesit

Buxheti i nevojshem

Nuk eshte percaktuar akoma

Projekte

Jane duke u perpunuar 3 skice ide perkatesisht: 1. Ngritja e nje punishteje salami, 2. Bimet aromatike mjekesore, 3. Krijimi i ambienteve turistike.

Problemi 2: Mungesa e nje tregu te sistemuar

Qellimi strategjik 2: Ngritja e tregut industrial ne zonen nen juridiksionin e bashkise brenda vitit 2005.

Objektivi 2.1

Percaktimi i hapesires ku do te ndertohet tregu.

Objektivi 2.2

Sensibilizimi i tregtareve ambulante ne lidhje me ambjentin e tregut.

Objektivi 2.3

Terheqja e komunitetit te biznesit ne zbatimin e projektit te tregut dhe sensibilizimi i komunitetit.

Objektivi 2.4

Percaktimi i taksave & tarifave favorizuese per shrytezimin e ambjentit te tregut.

Aktoret pergjegjes:

Bashkia Burrel (administate ; keshilli bashkiak)

Zyra e urbanistikes

Komuniteti i biznesit

Buxheti i nevojshem

60 000 \$

Projekt propozimi eshte duke u hartuar

b. Rendi dhe qetesia

Rendi dhe qetesia publike jane konsideruar si nje nga prioritetet kryesore ne bashkine e Burrelit. Bazuar kjo edhe ne situaten e krijuar qe nga viti 1997 ne kete qytet. Numri i incidenteteve te ndodhura ka qene relativisht i larte. Megjithe perpjektjet e bera nga strukturat perkatese perseri rendi dhe qetesia mbeten çeshtje delikate dhe te brishta. Permiresimi i ketij problemi do te ndikonte ndjeshem edhe ne zgjidhjen e shume problemeve te tjera, sidomos ne gjallerimin e biznesit dhe zbutjen e papunesise.

Problemi 3: Mungesa e sigurise

Qellimi strategjik 3: Vendosja e rendit dhe e qetesise ne territorin e bashkise

Objektivi 3.1

Krijimi i marredhenieve te ngushta bashkepunuese i bashkise me komisariatin e policies.

Objektivi 3.2

Rritja e besimit te komunitetit tek policia nepermjet takimeve, shperndarjes se informacionit dhe ndergjegjesimit.

Objektivi 3.3

Reduktimi i kriminalitetit dhe rritja e ndjenjes se sigurise tek qytetaret.

Objektivi 3.4

Pune me efektive e policise bashkiake si dhe permiresimi I infrastruktures rrugore dhe trafikut.

Aktoret pergjegjes

Bashkia burrel

Komisariati i policies

Policia bashkiake

Buxheti i nevojshem

Nuk nevojitet ndonje buxhet i vecante

Projekte

Akoma ne project ide

c. Infrastruktura

Bashkia e Burrelit ka planin e saj urbanistik te permiresuar ne vitin 1996. Megjithate shume ndertime te bera gjate 10 viteve te fundit nuk jane bazuar ne planin ekzistues. Ndertimet e paligjshme kane zene nje siperfaqe te konsiderueshme qe ka qene e planifikuar per zona te gjelberta ose funksione te tjera publike si rruge, trotuareetj. Bazuar ne rezultatet e pyetesorit te shperndare gjate muajit Maj 2004, pergjigja e dhene nga 95 % e qytetare eshte ne favor te prishjes te te gjithë ndertimeve paleje.

Prishja e unazes se qytetit ka bere qe gjithë makinat perfshire edhe ato me tonazh te rende te qarkullojne neper qytet. Kjo ka shkaktuar demtimin ne nje mase te konsiderueshme te rrugeve kryesore.

Problemi 4: Ndertimet e paligjshme

Qellimi strategjik 4: Zhvillimi I qytetit sipas planit urbanistik

Objektivi 4.1

Rivleresimi dhe permiresi i planit urban ekzistues brenda 2005

Objektivi 4.2

Realizimi i nje studimi per shtrirjen e kufijve te bashkise se Burrelit dhe percaktimi i sakte i zonave sipas funksioneve urbanistike deri ne 2005.

Objektivi 4.3

Prishja e te gjithë ndertimeve te paligjshme, sipas nje studimi paraprak.

Objektivi 4.4

Krijimi I ambienteve te pershtatshme per aktivitetin privat ne ambientet e liruara.

Objektivi 4.5

Legalizimi i atyre ndertimeve qe nuk prishin urbanistiken e qytetit.

Objektivi 4.6

Kthimi i siperfaqeve te liruara ne siperfaqe te gjelberta bazuar ne planin urbanistik te bashkise.

Aktoret pergjegjes:

Policia ndertimore

Bashkia Burrel

Zyra e urbanistikes

Buxheti i nevojshem

Nuk eshte percaktuar akoma

Projekte

Projekti eshte i gatshem dhe i ndare ne 4 faza

Problemi 5: Demtimi i rrugeve dhe trotuareve

Qellimi strategjik 5: Rikonstruksioni I plote I rugeve dhe trotuareve ne gjithe territorin e bashkise.

Objektivi 5.1

Rregullimi I rrugeve kryesore te qytetit

Objektivi 5.2

Ndertimi i unazes se qytetit.

Objektivi 5.3

Permiresimi i rrugeve dytesore

Objektivi 5.4

Vendosja e tabelave dhe sinjaleve rrugore ne te gjithe territorin e bashkise.

Aktoret pergjegjes

Bashkia Burrel

Ministria e rregullimit te territorit dhe turizmit

Buxheti i nevojshem

3 milion \$ per rikonstuksionin e plote te te gjithe rrjetit rrugor

Projekte

8 projekte te gatshme te fragmentarizuar

Problemi 6: Rrjeti elektrik i demtuar

Qellimi strategjik 6: Rritja e furnizimit me energji elektrike per te permbushur me mire kerkesat e popullates dhe biznesit.

Objektivi 6.1

Riparimi i rrjetit elektrik.

Objektivi 6.2

Ngritja e nje nenstacioni elektrik vetem per qytetin e Burrelit
Aktoret pergjegjes
Filiali elektrik
Bashkia Burrel

Buxheti i nevojshme:
1 million \$

Projekte:
I gatshem ne bashki

Problemi 7: Ndrichimi Publik

Qellimi strategjik 7: Rikonstruksion i plote i rrjetit te ndrachim publik deri ne 2005

Objektivi 7.1

Rikonstruksion i plote i rrjetit te ndrachim publik

Objektivi 7.2

Krijimi i nje ambienti me te sigurte per qytetaret si dhe rritja e mundesive per te shmangur incidented gjate nates.

Aktoret pergjegjes:
Bashkia Burrel

Buxheti i nevojshem:
220 mije \$

Projekte:
I perfunduar dhe i ndare ne miniprojekte

Problemi 8: Mungesa e fushes se mbetjeve urbane

Qellimi strategjik 8: Ndertimi i pikes se hedhjes dhe grumbullimit te mbeturinave dhe perpunimi i tyre.

Objektivi 8.1

Percaktimi i nje ambienti te pershtatshem per te ndertuar fushen e grumbullimit te mbeturinave.

Objektivi 8.2

Sigurimi i nje impianti per te perpunuar mbeturinat urbane.

Objektivi 8.3

Riorganizimi i pikave ekzistuese te grumbullimit te mbeturinave dhe shtimi i tyre ne ambientet publike.

Aktoret pergjegjes
Bashkia Burrel
Kompania e pastrimit

Biznesi
Qytetaret

Buxheti i nevojshem
250 mije \$

Projekte
Projekti eshte gati

Problemi 9: Numri i madh i familjeve te pastreha

Qellimi strategjik 9: Sigurimi I strehimit per 40% te familjeve te pastreha (800 familje te pastreha) deri ne 2007.

Objektivi 9.1

Hartimi i nje politike mbi strehimin duke iu pershtatur kushteve dhe mundesive aktuale te bashkise.

Objektivi 9.2

Evidentimi I vendeve te lira, ne pronesi te bashkise, qe mund te perdoren per ambiente strehimi dhe pershtatja e tyre.

Objektivi 9.3

Shitja e Hotelit dhe e disa ambienteve te tjera ne varesi te bashkise me çmime te uleta per familjet e pastreha.

Objektivi 9.4

Nxitja e sektorit privat per te ndertuar godina shumekateshe bazuar ne planin urbanistik te qytetit.

Aktoret pergjegjes:

Bashkia Burrel
Biznesi (firmat e ndertimit)

Buxheti i nevojshem:

I papercaktuar akoma

Projekte:

Jane duke u hartuar

Problemi 10: Mungesa e siperfaqeve te gjelberta

Qellimi strategjik 10: Shtimi i siperfaqeve te gjelberta si dhe rritja e numrit te pemeve dekorative.

Objektivi 10.1

Permiresimi i siperfaqeve te gjelberta ekzistuese. (parku kryesor dhe lulishtet e te gjitha shkollave dhe kopshteve te femijeve.

Objektivi 10.2

Shtimi i siperfaqeve te reja te gjelberta, nga 2 m² deri ne 7 m² per banore deri ne 2008.

Objektivi 10.3

Mbjellja e pemeve dekorative nga te gjithë pronaret e lokaleve ne rrugen kryesore te qytetit.

Aktoret pergjegjes:

Bashkia Burrel

Shoqata e mjedisit

Buxheti i nevojshem:

30 mije \$

Projekte

5 projekte te gatshme

Problemi 11: Fasada jo te rregullta

Qellimi strategjik 11: Rikonstruksioni i plote i fasadave te pallateve ne rrugen kryesore dhe dytesore.

Objektivi 11.1

Hartimi i nje plani te detajuar per permiresimin e fasadave te pallateve bazuar ne rregullat e planit urbanistik te qytetit.

Objektivi 11.2

Nderhyrje e menjehershme tek pallatet qe jane me te demtuara dhe rrezikojne banoret.

Aktoret pergjegjes:

Bashkia Burrel

Zyra e urbanistikes

Qytetaret

Buxheti:

70 mije \$

Projekte:

Projekti i gatshem

Problemi 12: Mungesa e parkingjeve te organizuara

Qellimi strategjik 12: Percaktimi i 3 vend –parkimeve te organizuara per automjetet.

Objektivi 12.1

Realizimi i nje studimi te plote per gjetjen e vendeve me te pershtatshme per parkime automjetesh.

Objektivi 12.2

Sensibilizimi i pronareve te automjeteve dhe i banoreve si dhe perfshirja e tyre ne procesin e percaktimit te vendeve per parkime.

Objektivi 12.3

Rritja e te ardhurave te bashkise nepermjet vendosjes dhe grumbullimit te tarifave mbi perdorimin e parkingjeve

Aktoret pergjegjjes :

Bashkia Burrel
Zyra e urbanistikes
Policia bashkiake

Buxheti i nevojshem:

30 mije \$

Projekte :

3 miniprojekte te gatshme

d. Arsim & Kulture

Popullsia e qytetit te Burrelit gjate viteve te fundit ka ardhur duke u rritur, si rezultat i levizjes se popullsisë nga zonat rurale perreth. Kjo ka bere qe numri i femijeve qe ndjekin shkollen fillore, tetevjeçare dhe te mesme te vije duke u rritur. Numri i nxenesve ne çdo klase eshte mbi 40. Gjendja fizike e shkollave eshte e mire. Problemet me kryesore kane te bejne me pajisjen e laboratoreve dhe bibliotekave te shkollës si dhe ambientet rrethuese te tyre. Keto probleme si dhe kualifikimi i vazhdueshem i mesueve jane te lidhur direkt me cilesine e mesim dhenies. Objektivat strategjike te percaktuara per arsimin jane ne perputhje me MDG, synimin 2.

Problemi 13: Infrastruktura arsimore jo e mjaftueshme

Qellimi strategjik 13: Permiresimi i te metave ne infrastrukturen arsimore, sipas standarteve bashkkohe

Objektivi 13.1

Ndertimi i nje shkolle te re brenda 2006.

Objektivi 13.2

Ngritja e bibliotekave dhe i sallave me kompjutera (rrjeti i internetit) ne te gjithë shkollat e mesme si dhe pasurimi i bibliotekave ne shkollat 8 – vjeçare.

Aktoret pergjegjjes:

Bashkia Burrel
Drejtoria arsimore
Drejtorite e shkollave
Buxheti i nevojshem:

300 mije \$

Projekte:

Po hartohen

Problemi 14: Mungesa e shkollave profesionale

Qellimi strategjik 14: Hapja e nje shkolle profesionale bazuar ne kerkesat reale te tregut te punes.

Objektivi 14.1

Realizimi i nje studimi per nevojat e tregut te punes ne bashkine e Burrelit.

Objektivi 14.2

Hapja e nje shkolle profesionale bazuar ne studimin e bere brenda vitit 2006.

Objektivi 14.3

Organizimi i nje fushate sensibilizuese me institucionet e ndryshme dhe donatoret per te siguruar mbeshtetjen e duhur financiare ne lidhje me hapjen e kurseve / shkolles profesionale.

Objektivi: 14.4

Krijimi i binjakezimeve me shkolla simotra.

Aktoret pergjegjes:

Drejtoria arsimore

Bashkia Burrel

Biznesi

Buxheti i nevojshem:

Nuk eshte percaktuar

Projekt

Faza e projekt idese

Problemi 15: Demtimi i godinave dhe bazes materiale ne kopshte dhe çerdhe.

Qellimi strategjik15: Krijimi i kushteve optimale per femijet e moshes 0- 6 vjeç ne menyre qe 90 % e femijeve te kesaj moshe te frekuentojne kopshtet dhe çerdhet.

Objektivi 15.1

Rikonstruksioni i te gjithë kopshteve dhe çerdheve ekzistuese.

Objektivi 15.2

Lirimi i te gjithë ambienteve te okupuara dhe pershtatja e tyre per kopshte dhe çerdhe.

Objektivi15.3

Sigurimi i fondeve te nevojshme per pajisjen me baze materiale didaktike e kopshteve dhe çerdheve. Sensibilizimi i donatoreve te ndryshem ne lidhje me kete problem.

Aktoret pergjegjes:

Bashkia Burrel

Drejtoria arsimore

Policia Bashkiake

Buxheti i nevojshem:

200 mije \$

Projekte:

Po hartohen.

Problemi 16: Mosfeksionimi i kendit te lojrave

Qellimi strategjik16: Permiresimi i ambientit te kendit te lojrave per te krijuar kushte sa me te pershtatshme per argetimin e femijeve ne kohen e lire.

Objektivi 16.1

Terheqja e interesit te biznesit per te investuar ne krijimin e ambienteve argetuese per femijet.

Objektivi 16.2

Permiresimi i ambientit ekzistues te kendit te lojrave, pershtatja e tij ne nje kend lojrash model deri ne vitin 2007.

Aktoret pergjegjes:

Bashkia Burrel

Buxheti i nevojshem:

300 mije \$

Projekti:

I gatshem

e. Shendetesi

Spitali i vetem qe ka qyteti ne pergjithesi ofron te gjitha sherbimet per qytetaret e bashkise dhe per te gjitha rrethin Mat. Mungesa e disa aparateve dhe pajisjeve te rendesishme kane bere qe sherbimet e ofruara te mos jene ne nivelin e duhur.

Pjese e sherbimit shendetesor jane edhe qendrat ambulatorie te lagjeve. Nje qender ambulatorie ofron sherbime per 6000 banore dhe 1 mjek i familjes u sherben 1700 qytetareve.

Problemi 17: Mungesa e laboratoreve dhe e infrastruktures se nevojshme per nje sherbim cilesor

Qellimi strategjik 17: Permiresimi i sistemit te shendetesise nepermjet permiresimeve te infrastruktures.

Objektivi 17.1

Rehabilitimi i plote i infrastruktures se laboratorit dhe pajisja e tij me materialet e nevojshme

Objektivi 17.2

Ngritja e repartit te terapise intensive

Objektivi 17.3

Permiresimi i nivelit te sherbimit ndaj pacienteve nepermjet trainimit dhe kualifikimit te metejshem te personelit mjekesor.

Objektivi 17.4

Rikonstruksioni i ambulancave te lagjeve dhe ndertimi i nje qendre te re.

Aktoret pergjegjes:
Drejtoria e sherbimit paresor
Bashkia Burrel

Buxheti i nevojshem
Nuk eshte percaktuar

Projekte;
Jo gati

9. Anekset

Strategic Plan Municipality of Burrel 2004 - 2008



January – June 2004

1. Foreword

The document of the strategic plan describes the trends of development for the city of Burrel and it gives an answer for the following questions.

Where we are? What do we have to do? Why do we have to do it? How can we do it? These are 4 major questions that the municipal administration in collaboration with its partners tried to give an answer.

Plani Strategjik që ju paraqitet është një ndermarrje e Bashkisë Burrel në bashkpunim me organizatën Hollandeze për zhvillim SNV. Nisur nga fakti që hartimi i planit strategjik është i domosdoshëm, stafi i bashkisë dhe strukturat jo të vartësisë nisen punën për grumbullimin e të dhënave dhe përpunimin e tyre që në muajin Dhjetor 2003. Procedura dhe aktivitetet u përcaktuan në bazë të një kalendari të miratuar nga grupi kordinues dhe keshilltaret e SNV.

Kontributi i komunitetit ishte me i madh, me idete dhe me sugjerimet e dhëna nga qytetarët që u mblodhën nëpërmjet pyetësorit dhe takimeve të drejtperdrejta.

Zhvillimi i planit strategjik është konceptuar në një ambient që ndryshon në mënyrë të vazhdueshme nga kërkesat e qytetarëve, nga rregullat dhe politikat e Qeverisë si dhe nga tendencat e zhvillimit. Plani Strategjik është një proces i cili ka qëllimet dhe objektivat të përcaktuara qartë, qëllime dhe objektiva që synojnë arritjen e vizionit "Ta bëjmë Burrelin qytet ku me pelqen të jetoj".

